



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2026

PROCES VERBAL-Tipi i kontratës – e hapur Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përfekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti: “F.V dyer ne kopshte dhe shkolla te Bashkise Vlore “

17,381,557(Shtatembdhjete million e treqind e tetedhjete e nje mije e peseqind e pesedhjete e shtate) Lekë pa TVSH

REF-96804-08-20-2026

Kodi CPV: 44221200-7 – Dyer

Tipi i procedures :E hapur pune- Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik-ku kushtet jane te percaktuar – me afat 12 muaj

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12-muaj

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *“Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”*.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- 2.1 Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e perlllogaritur e kontrates**.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi Ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne menyre qe t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesemarres te mundshem si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 2.2.2.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për kestet e maturuara te vitit 2026 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi Ligjor : Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nën 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kërkesa për vërtetimin e shlyerjes së taksave dhe tarifave vendore është vendosur për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve fiskale vendore të operatorit ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e taksave vendore. Verifikimi për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ushtron aktivitet, sipas të dhënave të QKB-së, siguron kontroll të plotë të detyrimeve të tij vendore. Kriteri është i lidhur me gjendjen ligjore të operatorit ekonomik dhe zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë ofertuesit, ndërsa dokumentacioni provues kërkohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari sipas përcaktimeve të DST.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të vogël** se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, **është jo më e vogël se vlera limit** e kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore **te deklaruara në organet tatimore** dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentim Ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme

për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Argumentimi Teknik :

Kërkesa për paraqitjen e kontratave të ngjashme është përcaktuar me qëllim verifikimin e kapacitetit teknik dhe profesional të operatorit ekonomik për realizimin e objektit të prokurimit, i cili përfshin furnizimin, transportin, çmontimin e dyerve ekzistuese, furnizimin dhe vendosjen e dyerve të reja, si dhe montimin dhe rregullimin përfundimtar të tyre. Realizimi i këtij objekti kërkon që operatori ekonomik të ketë eksperiencë në furnizimin dhe montimin e dyerve të ngjashme, në mënyrë që të garantohet njohja dhe zbatimi i kërkesave teknike lidhur me përmasat, materialet, konstruksionin, aksesoret, montimin dhe funksionimin e tyre. Përvoja e mëparshme në kontrata të ngjashme përbën një tregues të kapacitetit të operatorit ekonomik për të organizuar furnizimin, transportin dhe montimin e sasive të konsiderueshme të dyerve, për të koordinuar punimet në objekt dhe për të realizuar produktin sipas specifikimeve teknike dhe afateve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. **Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe është përcaktuar në mënyrë proporcionale me natyrën, volumin dhe kompleksitetin e furnizimit dhe montimit**, me qëllim garantimin e realizimit me cilësi dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 8 (tetë) punonjës, të përshtatshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate, sipas profileve të mëposhtme:

- **2 (dy) marangozë**, për përshtatjen, rregullimin dhe montimin e dyerve tamburato dhe elementëve prej druri;
- **3 (tre) montues dyersh**, për montimin, fiksimin, nivelimin dhe rregullimin e dyerve;

- **1 (një) punëtor alumini**, për përshtatjen dhe montimin e dyerve prej alumini;
- **1 (një) punëtor metalik**, për përshtatjen dhe montimin e dyerve të blinduara dhe elementëve metalikë;
- **1 (një) ndihmës montues**, për kryerjen e punimeve ndihmëse gjatë procesit të montimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi Ligjor : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi teknik për kriterin

Kërkesa për disponimin e minimalisht 8 (tetë) punonjësve, sipas profileve të përcaktuara, është vendosur në funksion të natyrës, volumit dhe kompleksitetit të punimeve objekt kontrate, të cilat përfshijnë furnizimin, transportin, çmontimin e dyerve ekzistuese, përshtatjen, montimin, fiksimin, nivelimin dhe rregullimin përfundimtar të dyerve të reja.

Objekti i prokurimit përfshin **lloje të ndryshme dyersh**, konkretisht dyer të brendshme tip tamburato, dyer të brendshme për ambiente sanitare prej alumini dhe dyer të blinduara me dy kanata. Për shkak të ndryshimit të materialeve, konstruksionit dhe mënyrës së montimit të këtyre produkteve, realizimi i punimeve kërkon personel me aftësi dhe kompetenca të përshtatshme për secilin proces pune.

Dy marangozët janë të nevojshëm për përshtatjen, montimin dhe rregullimin e dyerve tamburato dhe elementëve prej druri; **tre montuesit e dyerve** sigurojnë realizimin e proceseve të montimit, fiksimit, nivelimit dhe rregullimit të dyerve; **punëtori i aluminut** është i nevojshëm për montimin dhe përshtatjen e dyerve prej alumini; ndërsa **punëtori metalik** nevojitet për montimin dhe përshtatjen e dyerve të blinduara dhe elementëve metalikë. **Ndihmësi i montuesit** mbështet proceset e transportit në brendësi të objektit,

pozicionimit, fiksimit dhe punëve të tjera ndihmëse gjatë montimit. Përbërja e kërkuar e stafit synon të sigurojë **ndarjen e proceseve të punës sipas specializimit**, realizimin e njëkohshëm ose të njëpasnjëshëm të ndërhyrjeve në disa ambiente, si dhe respektimin e afateve të zbatimit të kontratës. Kërkesa për numrin dhe profilet e punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë **volumin e furnizimit dhe montimit, sasinë e dyerve të parashikuara, shumëllojshmërinë e tyre dhe nevojën për kryerjen e punimeve në mënyrë të organizuar dhe profesionale**. Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synon garantimin e kapacitetit teknik dhe profesional të operatorit ekonomik për realizimin e punimeve me cilësi, siguri dhe brenda afateve të përcaktuara, pa synuar kufizimin e konkurrencës.

Numri prej 8 punonjësish është përcaktuar në raport me volumin e përgjithshëm prej rreth 1,168 m² dyer dhe me natyrën e ndryshme të produkteve që kërkojnë procese të ndryshme montimi dhe përshtatjeje. Organizimi i stafit në profile të veçanta mundëson kryerjen e punimeve në mënyrë të koordinuar dhe shmang varësinë e realizimit të të gjithë objektit nga një numër i kufizuar punonjësish me profil të përgjithshëm.

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë të vlefshme ISO 9001:2015, ose standardin e përditësuar/ekuivalent, për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, të lëshuar nga një Organ i Vlerësimit të Konformitetit të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Objekti/fusha e certifikimit duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit dhe të mbulojë veprimtari të lidhura me furnizimin dhe/ose montimin e dyerve, produkteve të ngjashme të ndërtimit apo veprimtari të ngjashme me objektin e kontratës. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në momentin e paraqitjes së ofertës.

Argumentimi Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjë mbeshtetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

-Kërkesa për ISO 9001:2015 është përcaktuar për të garantuar që operatori ekonomik të disponojë një sistem të menaxhimit të cilësisë për proceset që lidhen me furnizimin dhe montimin e dyerve. Kjo është e nevojshme për shkak të volumit dhe shumëllojshmërisë së dyerve objekt kontrate dhe proceseve që përfshihen, si furnizimi, përshtatja, montimi, fiksimi, nivelimi dhe rregullimi përfundimtar. Përcaktimi i fushës së certifikimit në përputhje me objektin e prokurimit siguron lidhjen reale të certifikimit me aktivitetin që do të realizohet. Kriteri synon garantimin e cilësisë dhe reduktimin e riskut të mospërputhjeve gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.4.Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion teknik të produktit të ofruar, të lëshuar nga prodhuesi dhe/ose nga laboratorë apo Organizma të Vlerësimit të Konformitetit të akredituar, sipas natyrës së dokumentit dhe kërkesave të standardeve përkatëse.

-Për dyert e brendshme/tamburato, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e testimit që provon përmbushjen e kërkesave përkatëse të performancës mekanike të dyerve, sipas standardeve të aplikueshme, përfshirë standardet:

- SSH EN 1192:1999;
- SSH EN 947:1998;
- SSH EN 948:1999;
- SSH EN 949:1998;
- SSH EN 950:1999,

ose standardet përkatëse të përditësuara/ekuivalente në fuqi.

Dokumentacioni i testimit duhet të identifikojë qartë produktin/modelin e testuar dhe, kur është e aplikueshme, prodhuesin, në mënyrë që të mund të verifikohet lidhja ndërmjet produktit të testuar dhe produktit të ofruar.

-Për dyert e tualeteve prej alumini dhe dyert e blinduara, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion teknik dhe, kur kërkohet nga specifikimet teknike, raporte/certifikata testimi sipas standardeve përkatëse të produktit, duke evidentuar karakteristikat teknike të kërkuara për secilin produkt.

Dokumentet duhet të jenë të lëshuara nga prodhuesi dhe/ose nga laboratorë/Organizma të Vlerësimit të Konformitetit të akredituar sipas fushës përkatëse të akreditimit.

Dokumentacioni duhet të jetë i vlefshëm në momentin e paraqitjes së ofertës, kur dokumenti ka afat vlefshmërie, dhe duhet të jetë i identifikueshëm në mënyrë që të mundësojë verifikimin e përputhshmërisë së produktit të ofruar me kërkesat teknike.

Argumentimi :Kriteri i vendosur, eshte ne zbatim te nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 39 pika 8 ku citohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Argumentimi teknik Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit teknik dhe të dokumentacionit të testimit për produktet objekt prokurimi është përcaktuar me qëllim verifikimin objektiv të përputhshmërisë së produkteve të ofruara me kërkesat teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Objekti i prokurimit përfshin furnizimin dhe montimin e disa kategorive të dyerve, konkretisht **dyer të brendshme tip tamburato, dyer të ambienteve sanitare prej alumini dhe dyer të blinduara**, të cilat ndryshojnë për nga materiali, konstruksioni, mënyra e përdorimit dhe karakteristikat teknike.

Për **dyert e brendshme/tamburato**, kërkesa për dokumentacion testimi sipas standardeve të përcaktuara synon të mundësojë verifikimin e karakteristikave të tyre të performancës mekanike, duke përfshirë qëndrueshmërinë dhe sjelljen e elementëve të derës ndaj veprimeve mekanike të parashikuara nga standardet përkatëse.

Dokumentacioni i testimit kërkohet të identifikojë qartë **produktin/modelin e testuar dhe prodhuesin**, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të mund të verifikojë se rezultatet e testimit i referohen produktit konkret të ofruar dhe jo një produkti tjetër me karakteristika të ndryshme. Për **dyert e aluminit dhe dyert e blinduara**, kërkesa për dokumentacion teknik dhe, sipas rastit, raporte ose certifikata testimi synon verifikimin e karakteristikave specifike të këtyre produkteve, në përputhje me materialin, konstruksionin dhe përdorimin e tyre. Dokumentacioni shërben për të verifikuar, ndër të tjera, përputhshmërinë e konstruksionit, materialeve, aksesorëve dhe karakteristikave të tjera të kërkuara në specifikimet teknike. Kërkesa që dokumentet të lëshohen nga **prodhuesi dhe/ose laboratorë apo Organizma të Vlerësimit të Konformitetit të akredituar sipas fushës përkatëse** synon të sigurojë besueshmërinë dhe gjurmueshmërinë e informacionit teknik të paraqitur. Përcaktimi i kërkesës që dokumentacioni të jetë i identifikueshëm dhe të mundësojë lidhjen me produktin/modelin e ofruar është i nevojshëm për të shmangur paraqitjen e dokumenteve që i përkasin produkteve të tjera dhe për të mundësuar një **vlerësim të drejtë, objektiv dhe të verifikueshëm të ofertave**. Kriteri është përcaktuar në funksion të **natyrës, përdorimit, volumit dhe kërkesave teknike të produkteve objekt prokurimi** dhe synon garantimin e cilësisë, sigurisë, qëndrueshmërisë dhe përputhshmërisë së produkteve që do të furnizohen dhe montohen.

Se fundmi Kërkesa për dokumentacion teknik dhe testime është vendosur për të mundësuar verifikimin objektiv të përputhshmërisë së produkteve të ofruara me specifikimet teknike. Duke qenë se objekti përfshin dyer tamburato, dyer alumini dhe dyer të blinduara, të cilat kanë karakteristika dhe kërkesa të ndryshme teknike, dokumentacioni i prodhuesit dhe, sipas rastit, dokumentacioni i testimit siguron prova të verifikueshme mbi performancën dhe karakteristikat e produkteve. Identifikimi i modelit dhe prodhuesit mundëson lidhjen e

dokumentacionit me produktin konkret të ofruar dhe shmang përdorimin e dokumenteve që i përkasin produkteve të tjera. Kriteri synon garantimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe përputhshmërisë së produkteve me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

2.3.5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor, realizimin e të gjitha proceseve dhe punimeve të nevojshme për dorëzimin e dyerve të furnizuara, të montuara, të rregulluara dhe plotësisht funksionale, në përputhje me specifikimet teknike dhe preventivin:

- **transportin e dyerve deri në objektin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor;**
- **shkarkimin dhe sistemimin e tyre në objekt;**
- **çmontimin e dyerve ekzistuese;**
- **ngarkimin, transportin dhe largimin e materialeve të dala nga çmontimi;**
- **përgatitjen e hapjeve për montim, kur është e nevojshme;**
- **furnizimin dhe vendosjen e dyerve të reja;**
- **montimin e kornizave, bravave, dorezave, menteshave dhe aksesoreve përkatës;**
- **rregullimin dhe kontrollin e funksionimit të dyerve pas montimit;**
- **pastrimin e zonës së punës pas përfundimit të punimeve.**

Të gjitha punimet duhet të kryhen në përputhje me specifikimet teknike, preventivin dhe kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi ligjor dhe teknike : Kriteri i vendosur, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 39 pika 8 ku citohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës: Kërkesa për paraqitjen e deklaratës së operatorit ekonomik për realizimin e transportit, shkarkimit, çmontimit, largimit të materialeve, përgatitjes së hapjeve, furnizimit, montimit, rregullimit dhe pastrimit të zonës së punës është përcaktuar në funksion të natyrës së objektit të prokurimit, i cili përfshin jo vetëm furnizimin e dyerve, por edhe vendosjen dhe montimin e tyre në objektet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Nga pikëpamja teknike, realizimi i kontratës kërkon një proces të integruar, që fillon me transportin dhe shkarkimin e produkteve dhe vijon me çmontimin e dyerve ekzistuese, përgatitjen e hapjeve, montimin e kornizave dhe kanateve, instalimin e aksesoreve, rregullimin dhe kontrollin e funksionimit të dyerve. Përfshirja e këtyre proceseve në detyrimet e operatorit ekonomik është e nevojshme për të garantuar që produkti i furnizuar të vendoset dhe të funksionojë në përputhje me specifikimet teknike. Përfshirja e **çmontimit dhe largimit të dyerve ekzistuese** është e nevojshme për shkak se ndërhyrja realizohet në hapje ekzistuese dhe kërkon largimin e elementëve aktualë përpara vendosjes së dyerve të reja. Gjithashtu, largimi i materialeve të dala nga çmontimi siguron që procesi i punës të përfundojë në kushte të rregullta dhe pa krijuar pengesa apo mbetje në objekt. Përgatitja e hapjeve, kur është e nevojshme, si dhe montimi, nivelimi dhe rregullimi përfundimtar janë të domosdoshme për garantimin e **funksionimit korrekt, qëndrueshmërisë dhe jetëgjatësisë së dyerve**. Nga pikëpamja kontraktuale, kjo kërkesë përcakton në mënyrë të qartë **detyrimet dhe përgjegjësitë e operatorit ekonomik**, duke shmangur paqartësitë

lidhur me kostot dhe punët ndihmëse që janë të nevojshme për dorëzimin e produktit të montuar dhe funksional. Kërkesa është vendosur në përputhje me parimin që kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e prokurimit të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës dhe të synojnë realizimin e plotë të saj. Ajo nuk kërkon një kapacitet të veçantë që nuk lidhet me objektin, por formalizon detyrimet që janë të domosdoshme për realizimin e **furnizimit dhe vendosjes së dyerve**. Për këtë arsye, kërkesa për deklaratë konsiderohet **e nevojshme, e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe teknikisht e justifikuar**, pasi siguron që operatori ekonomik të marrë përsipër të gjithë procesin e furnizimit dhe montimit deri në dorëzimin e dyerve të instaluar, të rregulluara dhe funksionale.

Se fundmi Kërkesa është përcaktuar për të garantuar realizimin e plotë të objektit “Furnizim dhe vendosje dyersh”. Objekti përfshin jo vetëm furnizimin, por edhe transportin, çmontimin e dyerve ekzistuese, largimin e materialeve, përgatitjen e hapjeve, montimin e dyerve dhe aksesoreve, rregullimin dhe pastrimin përfundimtar. Deklarata përcakton qartë përgjegjësitë e operatorit ekonomik dhe shmang paqartësitë lidhur me punimet ndihmëse dhe kostot e tyre. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, proporcionale me natyrën e punimeve dhe e nevojshme për dorëzimin e produktit të montuar dhe funksional.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës garanton mallrat objekt prokurimi dhe montimin e tyre për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet, duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të punimeve nga Autoriteti Kontraktor.

Garancia duhet të mbulojë, ndër të tjera:

- defektet e materialit;
- defektet e prodhimit;
- deformimet që nuk vijnë nga përdorimi i papërshtatshëm;
- defektet e bravave, dorezave, menteshave dhe aksesoreve të furnizuar nga operatori;
- defektet që lidhen me montimin;
- vështirësitë e hapjes dhe mbylljes që vijnë nga montimi jo i rregullt;
- shkëputjen ose dëmtimin e elementeve të montimit.

Në rast konstatimi të një defekti të mbuluar nga garancia, Operatori Ekonomik duhet të kryejë verifikimin dhe ndërhyrjen për riparimin e tij brenda një afati maksimal prej 10 (dhjetë) ditësh pune nga data e njoftimit nga Autoriteti Kontraktor.

Nëse defekti nuk mund të riparohet, Operatori Ekonomik duhet të zëvendësojë produktin ose elementin përkatës me një produkt/element me karakteristika teknike të njëjta ose më të mira, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Të gjitha shpenzimet për transportin, materialet, pjesët, punën, çmontimin dhe rimontimin që lidhen me realizimin e garancisë mbulohen nga Operatori Ekonomik.

Argumentimi ligjor dhe teknike : Kriteri i vendosur, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 39 pika 8 ku citohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës:

Kërkesa për garantimin e mallrave dhe montimit të tyre për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet është përcaktuar me qëllim sigurimin e cilësisë, funksionalitetit dhe qëndrueshmërisë së produkteve të furnizuara dhe të punimeve të montimit.

Objekti i prokurimit përfshin furnizimin dhe montimin e një numri të konsiderueshëm dyeresh të llojeve të ndryshme, konkretisht dyer të brendshme tip tamburato, dyer prej alumini për ambiente sanitare dhe dyer të blinduara. Këto produkte janë elementë funksionalë të objekteve dhe do të jenë subjekt i përdorimit të vazhdueshëm, ndaj kërkohet që ato të ruajnë karakteristikat e tyre funksionale dhe teknike gjatë periudhës së përdorimit.

Periudha minimale e garancisë prej **2 vjetësh** synon të sigurojë që defektet që mund të rezultojnë nga materiali, procesi i prodhimit ose montimi të trajtohen nga operatori ekonomik pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për komponentët funksionalë të dyerve, si **bravat, dorezat, menteshat dhe aksesoret**, si dhe për elementët e fiksimit dhe montimit. Përfshirja në garanci e vështirësive në hapjen dhe mbylljen e dyerve që vijnë nga montimi jo i rregullt synon të garantojë jo vetëm cilësinë e produktit, por edhe **cilësinë e instalimit të tij në objekt**. Në këtë mënyrë, operatori ekonomik mban përgjegjësi për rezultatin përfundimtar të furnizimit dhe montimit. Përcaktimi i afatit maksimal prej **10 ditësh pune** për verifikimin dhe ndërhyrjen pas njoftimit për defekt synon të sigurojë një reagim të arsyeshëm dhe në kohë ndaj problematikave që mund të ndikojnë në përdorimin normal të dyerve dhe në funksionimin e objekteve. Parashikimi i zëvendësimit të produktit ose elementit përkatës, kur defekti nuk mund të riparohet, garanton vazhdimësinë e funksionalitetit dhe shmang kostot shtesë për Autoritetin Kontraktor. Gjithashtu, përcaktimi që shpenzimet për **transportin, materialet, pjesët, punën, çmontimin dhe rimontimin** të përballohen nga operatori ekonomik është i nevojshëm për të bërë efektive garancinë dhe për të shmangur transferimin e kostove të defekteve të mbuluara nga garancia te Autoriteti Kontraktor. Kërkesa për garanci është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, proporcionale me natyrën dhe përdorimin e produkteve dhe synon mbrojtjen e interesit ekonomik të Autoritetit Kontraktor, sigurimin e cilësisë së furnizimit dhe montimit dhe garantimin e funksionimit normal të dyerve gjatë periudhës së garancisë. **Se fundmi: Kërkesa për garanci minimale 2-vjeçare është përcaktuar për të garantuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e dyerve dhe të montimit të tyre. Duke qenë se dyert do të përdoren në mënyrë të vazhdueshme dhe objekti përfshin produkte të ndryshme me komponentë mekanikë dhe elementë montimi, është e nevojshme që defektet e materialit, prodhimit, aksesoreve dhe montimit të mbulohen nga operatori ekonomik për një periudhë të përcaktuar. Afati 10-ditor për ndërhyrje siguron reagim në kohë, ndërsa detyrimi për riparim ose zëvendësim pa kosto shtesë mbron Autoritetin Kontraktor nga shpenzimet që lidhen me defektet e mbuluara nga garancia. Kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin dhe proporcional me natyrën dhe përdorimin e produkteve.**

2.3.7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës garanton se:

- **mallrat objekt prokurimi janë të reja dhe të papërdorura;**
- **mallrat nuk janë produkte të përdorura, të rikonstruktura ose të riparuar;**
- **produktet janë prodhuar sipas specifikimeve teknike dhe standardeve përkatëse;**

- produktet do të furnizohen të kompletuara dhe të gatshme për montim;
- çdo derë do të shoqërohet me të gjithë komponentët dhe aksesoret e nevojshëm për funksionimin e plotë;
- komponentët e furnizuar do të jenë në përputhje me modelin dhe specifikimet e derës;
- produktet do të jenë të përshtatshme për përdorimin dhe kushtet e përcaktuara në specifikimet teknike.

Argumentimi :Kërkesa për paraqitjen e deklaratës me anë të së cilës operatori ekonomik garanton se mallrat objekt prokurimi janë të reja, të papërdorura dhe të furnizuara të kompletuara është përcaktuar me qëllim sigurimin e cilësisë, integritetit dhe funksionalitetit të produkteve që do t'i dorëzohen Autoritetit Kontraktor.

Objekt i prokurimit është furnizimi dhe montimi i dyerve të llojeve të ndryshme, të cilat do të instalohen në objektet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor dhe do të jenë pjesë funksionale e tyre. Për këtë arsye, është e nevojshme që produktet të jenë **të reja dhe të papërdorura**, në mënyrë që të shmanget përdorimi i produkteve të konsumuara, të dëmtuara, të rikonstruara ose të riparuar, të cilat mund të ndikojnë në jetëgjatësinë, sigurinë dhe funksionalitetin e tyre. Kërkesa që produktet të jenë prodhuar në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet përkatëse synon të sigurojë që dyert e furnizuara të përmbushin karakteristikat teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe të jenë të përshtatshme për përdorimin e parashikuar. Kërkesa për furnizimin e dyerve **të kompletuara dhe të gatshme për montim**, së bashku me të gjithë komponentët dhe aksesoret e nevojshëm, është e nevojshme për të shmangur mungesën e elementeve gjatë procesit të instalimit dhe për të garantuar që produkti të jetë plotësisht funksional pas montimit. Në veçanti, përfshirja e bravave, dorezave, menteshave, mekanizmave të mbylljes dhe elementëve të tjerë të nevojshëm duhet të jetë në përputhje me modelin dhe karakteristikat e derës, pasi përdorimi i komponentëve të papërshtatshëm mund të ndikojë në **sigurinë, funksionimin, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e produktit**. Gjithashtu, kërkesa që produktet të jenë të përshtatshme për kushtet e përdorimit të përcaktuara në specifikimet teknike siguron që produkti i furnizuar të jetë i përshtatshëm për ambientin ku do të instalohet, përfshirë rastet e dyerve të aluminit për ambiente sanitare dhe dyerve të blinduara. Kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe është teknikisht i nevojshëm për garantimin e cilësisë, sigurisë, funksionalitetit dhe jetëgjatësisë së produkteve. Deklarata e operatorit ekonomik krijon gjithashtu një angazhim të qartë kontraktual për gjendjen dhe kompletimin e mallrave që do të furnizohen.

Se fundmi :Kërkesa është përcaktuar për të garantuar që dyert e furnizuara të jenë të reja, të papërdorura, të prodhuara sipas specifikimeve teknike dhe të furnizuara të kompletuara me të gjithë komponentët dhe aksesoret e nevojshëm. Kjo shmang riskun e furnizimit të produkteve të përdorura, të rikonstruara ose me komponentë të papërshtatshëm dhe garanton funksionimin e plotë pas montimit. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe synon sigurimin e cilësisë, sigurisë, qëndrueshmërisë dhe jetëgjatësisë së dyerve.

Argumentimi i specifikimeve teknike : *Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.*

Shënim: Përcaktimi i specifikimeve teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë **funksionin e dyerve, kushtet e përdorimit, karakteristikat konstruktive të objekteve, kërkesat për qëndrueshmëri, siguri dhe funksionalitet**, si dhe nevojën për realizimin e montimit në hapësirat ekzistuese. Objekti i prokurimit përfshin furnizimin dhe vendosjen e tre kategorive kryesore të dyerve: **dyer të brendshme tip tamburato, dyer të ambienteve sanitare prej alumini dhe dyer të blinduara**. Për secilën kategori janë përcaktuar kërkesa teknike në përputhje me Për të gjitha kategoritë e dyerve është kërkuar që materialet të jenë **të reja dhe pa defekte**, ndërsa produktet të jenë të përshtatshme për kushtet konkrete të përdorimit.

Kërkesa për furnizimin e dyerve së bashku me **të gjithë aksesoret dhe elementët e nevojshëm për montim dhe funksionim** synon të shmangë mungesat e komponentëve dhe ndërprerjet gjatë procesit të instalimit.

Përfshirja e **matjes në objekt, transportit, çmontimit të dyerve ekzistuese, montimit, rregullimit dhe pastrimit** është e nevojshme për shkak se kontrata nuk konsiston vetëm në furnizimin e produktit, por në dorëzimin e dyerve të montuara dhe funksionale.

Përcaktimi i tolerancave dhe përshtatjes sipas matjeve faktike në objekt synon të shmangë problematikat që mund të lindin nga ndryshimet ndërmjet dimensioneve nominale dhe hapjeve ekzistuese.

funksionin dhe kushtet konkrete të përdorimit. Është, specifikimet teknike janë përcaktuar mbi bazën e **nevojave funksionale dhe teknike të Autoritetit Kontraktor**, duke synuar sigurimin e produkteve të përshtatshme për përdorimin e parashikuar, me qëndrueshmëri dhe funksionalitet të mjaftueshëm.

Kërkesat teknike janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe me kushtet e përdorimit të produkteve dhe synojnë të sigurojnë **cilësi, siguri, qëndrueshmëri,**

funksionalitet dhe montim korrekt, duke shmangur specifikime të panevojshme që nuk lidhen me performancën e produktit.

NJESIA E PROKURIMIT